



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1076/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Adnan Konoshvci dhe Rustem Thaqi anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Klines, Ilir Hoti, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë-dega në Klinë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.1076/2021 i datës 04.11.2021, i kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Klinës, Ilir Hoti, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë-dega në Klinë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, me të cilën ka kërkuar që të futet në listën e kandidatëve të Kuvendit Komunal në Komunën e Klinës.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.1076/2021, i paraqitur nga Ilir Hoti , për Kuvend Komunal, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë-dega në Klinë, me të cilën ndër të tjera ka pretenduar se tek shpërndarja e ulëseve në Kuvendin Komunal të Komunës së Klinës, është shkelur neni 8 paragrafi 8.4 i Ligjit nr.03/L-72.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se, Kandidati për Kuvend Komunal nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë-dega në Klinë, Ilir Hoti, kërkon që ti mundësohet të futet në listën përfundimtare për kandidat në Kuvendin Komunal të Klinës. Paneli pas shqyrtimit të apelit erdhi në përfundim se apeli i ushtruar nga Ilir Hoti, Kandidat për Kuvend Komunal nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje është i pa bazuar.

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e nenit 8 paragrafi 4 të Ligjit nr.03/L-72 i cili nën përcakton: *“Nëse pas ndarjes së vendeve, të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni, kandidatëve të gjinisë pakicë nuk u janë ndarë së paku 30% nga numri i përgjithshëm i vendeve të subjektit politik, kandidati i fundit i zgjedhur i gjinisë shumicë zëvendësohet nga një kandidat i përshtatshëm i gjinisë tjetër në listën e rirenditur për kandidatë, derisa numri i përgjithshëm i vendeve të ndara për gjininë pakicë të jetë së paku 30%”*. Gjithashtu pretendimet e apellesit nuk janë të mbështetura as në Rregullën Zgjedhore të KQZ-së nr 08/2013 Certifikimi i subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre është e përcaktuar formula për ndarjen e ulëseve, ku nëse numri i kandidatëve që kanë fituar mandate është shtatë (7) atëherë numri më i vogël nga të dy gjinitë duhet të jetë katër (4), pra duhet të jen meshkuj dhe tri (3) femra. Mbi këtë bazë, Paneli konstaton se KQZ-ja, me rastin e marrjes së vendimit (KQZ), 2948/2021 të datës 03.11.2021 drejt ka zbatuar dispozitën ligjore të nenit 8.3 dhe 8.4 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale për shpërndarjen e vendeve për anetarë të Kvendeve Komunale si dhe Rregullën Zgjedhore të KQZ-së nr 08/2013.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje parregullsi ashtu siç pretendon apellesi.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.1076/2021 më datën 07.11.2021



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.